



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ..... 52 ..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 29/ 04 / 2024

**VENDIM**

Nr.11, datë 29 /04/2024

**PËR**

**PROBLEMATIKAT E KONSTATUARA NË DIGËN E RUBJEKËS TË BASHKISË SHIJAK**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 29. 04.2024 mori në shqyrtim Problematikat e konstatuara në digën e Rubjekës me H= 16 m dhe L = 472 ml që administrohet nga Bashkia Shijak.

Në shkresat e dërguara nga Prefektura Durrës dhe Bashkia Shijak si dhe nga situata e prezantuar nga përfaqësues të Bashkisë dhe Prefekturës, rezulton se në anën e majtë të digës ka një rrëshqitje në pjesën e poshtme të digës në një gjatësi prej 40m e cila mund të ndikoj në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e digës. Kjo rrëshqitje është evidentuar nga KKDM që prej një viti dhe nga vrojtimet e fundit rezulton se masa e dheut në anën e majtë të digës po vazhdon lëvizjen poshtë duke rritur problematiken në lidhje me sigurinë dhe qëndrueshmërinë e digës. Nga vrojtimet e kryera në terren rezulton se nga Bashkia Shijak nuk ka asnjë monitorim me instrumenta të këtyre lëvizjeve dhe nuk është paraqitur asnjë projekt për rehabilitimin e digës pranë KKDM për tu shqyrtuar dhe miratuar sipas legjislacionit në fuqi. Në digë nuk ka të instaluar sistemeve të monitorimit të tyre dhe Bashkia Shijak nuk ka dorëzuar ndonjë të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile dhe nuk ka sisteme alarmi apo harta të përmbytjeve sipas kërkesave teknike dhe dhëzimeve të KKDM. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

1- Ti kërkohet Bashkisë Shijak si shfrytëzuese e digës së Rubjekës:

- Të marrë masa urgjente për bllokimin e rrugës mbi kurorën e digës, monitorimin dhe kontrollin cdo jave të lëvizjeve të rrëshqitjes në trupin e digës si dhe uljen graduale të nivelit të ujit në rezervuar
- Të instalojnë urgjent sistemin e monitorimit gjeodezik dhe të kryejë matjet gjeodezike në trupin e digës si dhe në vecanti në zonën e rrëshqitjes. Informacioni për këto matje, rezultatet e tyre dhe konkluzionet e shfrytëzuesit të digës duhet të dorëzohen pranë KKDM përpara fillimit të sezonit ujëshumë në Nëntor 2024
- Të marrë masat për përgatitjen sa më shpejt të jetë e mundur të projektit të zbatimit për ndërhyrjen emergjente të rehabilitimit të rrëshqitjes në trupin e digës, kontrollin dhe rehabilitimin e shkarkuesit katastrofik sipërfaqësor dhe kontrollin e qëndrueshmërisë së digës, FV të instrumentave për monitorimin e digës dhe sistemin e alamrit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi
- Të hartoj Rregulloren e shfrytëzimit, monitorimit dhe sigurisë së digës sipas kërkesave të nenit 29 të VKM së mësipërme
- Të kryej matjet e volumeve aktuale të ujit në rezervuar dhe të hartoj kurbat e volumeve dhe të siperfaqes së ujit për rezervuarin deri në nivelin maksimal të ujit të parashikuar në projekt sipas kërkesave të nenit 30 të VKM së mësipërme
- Të përgatit planin e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile për shkak të prishjes së mundshme të digës apo prurjeve maksimale që mund të vijnë në rezervuar. Ky plan duhet të jetë i shoqëruar me hartat e përmbytjeve sipas kërkesave të nenit 35 të VKM së mësipërme.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**